



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	14.11.2023	21.11.2023	2023/0863

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.11.2023, OE “INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0863, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË” me nr. të prokurimit: "214-23-5718-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: xx,xxx €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0863 i dt:02.11.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Qëllimi Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Vendimi i OSHP-së

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar dhe kemi plotësuar kërkesen e DT dhe me datë 15.08.2023 për qudi kemi marrë vendim për tenderuesin e eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar foto apo dëshmi të mjaftueshme, por ju me qëllim të dëmtimi të

Kompanis tonë nuk keni kërkuar sqarime kurse keni përdorur standarte të dyfishta pasi që për OE e rekomanduar për kontratë. Përdorimi i standarteve të dyfishta përderi sa OE të rekomanduar keni kërkuar sqarime lenë për të dyshuar se ka keqpërdorime në këtë AP ne pas qasjes jemi duke anliazuar Oferten e OE dhe brenda affatit ligjorë,do e plotësojm atë. Arsyetimet e AK se nuk kemi ofruar makineri të mjaftueshme është kejt se e pavërtet pasi që në oferten tonë kemi bashkangjitur të gjitha dëshmit sipas kërkesave dhe mungesa e fotove nuk permben ndonje shkelje ligjore e cila ka mundur të sqarohet. Arsyetimet tuaja janë kerjtesisht të pabazuara

Arsyetimi I AK për eliminimin e ofertës tonë është I pabazë pasi që në ofertë egzistojn të gjitha makineritë e kërkuara dhe mos kërkimi I fotove I bie standart I dy fishtë pasi që vetë AK OE të rekomanduar I ka kërkuar dhe pse Brenda për Brenda ofetës dëshmohe se ky OE është I papërgjegjshem për arsye se:

Pas analizë së ofertave ne pamë që OE i rekomanduar ka ofruar një Marrëveshje me një biznes smajl

Jakupaj B.I. me nr 810448557 i cili del të jetë i shuar dhe dokumenti i tilë llogaritet si mashtrim dhe eshte jo

valid që e bënë oferten të papërgjegjshme.

SHIH linkun në ARBK: <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,50179>

Pra biznesi është I shuar me datë 11.05.2023 dhe OE ka marrëveshjen e nënshkuar me datë 22.06.2023.

Edhe pse ne kemi ofruar argumente AK nuk ka vepruar konform me LPP dhe vendimin tuaj si OSHP ku keni kërkuar që të bëhet RIVLERSIM por AK pas një muaji në form krejtë të paligjëshme merre vendim ndaj kërkeses për ri-shqyrtim pas më shumë se 2 muajve kurse për një kerkes për ri-shqyrtim afati është maksimumi 6 ditë.

Se AK ka bërë shkelje ligjore dhe ka përdorur standarte të dyfishta shifet qartë sepse pa e kthyer lenden në RIVLERSIM ka kërkuar nga OE i prefruar i saj sqarime kurse saqime për neve si OE edhe pse ka qenë e Obliguar me vendimin tuaj nuk na kanë kërkuar.

Për sa u tha më lartë kërkojm që të aprpvoni ankesen tonë dhe ta URDHERONI AK të veproj konform LPP-së.

P.S brenda afatit ligor do e plotesojm ankesen.


KRITERET PËR VLERËSIM

Dëshmi 4:Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi listën e makinerisë automjeteve të nënshkruar dhe e vulosur nga OE (pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit me fotografi. Në rast se OE nuk posedon makineri automjete në pronësi të tij atëherë marrëveshjen e marrjes me qira për projektin në fjalë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË**” me numër të prokurimit: “**214-23-5718-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:		
1.	MSS Mobile Sanitary Services SH.P.K. 810530354	OE MSS Mobile Sanitary Services SH.P.K. Ka plotësuar kërkesat administrative dhe teknike dhe rekomandohet për kontratë
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.	OE Grup i Operatorëve Ekonomik INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.; SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., Rr.Garibaldi, 10 000, Prishtin, Kosovë ka deshtuar në kriterin: 1.Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 2 - Lista prej minimum 113 punetore që drejtpërdrejtë janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve përkatës për këtë projekt. Dëshmi 2 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi listën e stafit origjinalë e nënshkruar dhe vulosur duke bashkëngjitur kontratat ose marrëveshja e punës valide në mes të OE dhe punëtorit për këtë projekt. Sqarim Gjate realizimit të kontratës AK mund të kërkoj rritjen e numrit të punetoreve mvaresisht nga nevojat e AK. 2. Kërkesa 3-Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxher të projektit Dëshmi 3:Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit (mundet të jete njeri nga stafi) OE nuk ka sjelle liste të përgatitura, nënshkruar dhe vulosur sipas Njoftimit për kontratë dhe DT OE ka sjelle liste Listen të pagave nga Administrata Tatimore (pagesa e kontributeve) 3.OE ka deshtuar në kriterin Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa 5: Operatori ekonomik duhet të posedoj pajisjet për realizimin të kësaj kontrate: makinë për pastrimin e dyshemesë dhe lustrimin – së paku 5 copë; makine (kositese) me motor për kosjeten e barit 20 copë; makinë me motor për pastrimin e hapësirës së jashtme (makina duhet të jete me fshese) 3 cope; Makine për larjen e tepiëve 3 cope; makina thithëse –dhe mjetet e tjera të punës sipas Aneksit 1. Dëshmi 5:Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi listën e veglave dhe mjeteve të punës që posedon e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose kontratën ose marrëveshjen për marrjen me qira të automjeteve. Veglat dhe mjetet të dëshmohen me foto.

 B36 Formulimi standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur" 10

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës nr.863/23 ka të bëjë me arsyet e eliminimit të OE

ankues, ku sipas OE ankues i njëjti është eliminuar me arsyetim se nuk ka ofruar fotografitë e pajisjeve të kërkuara/ofruara.

OE pretendon se një gjë e tillë ka mund të plotësohet/sqarohet përmes sqarimeve shtesë, mirëpo AK për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë, për OE ankues nuk ka kërkuar sqarime.

Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimorë, dosjes së tenderit, raportit të komisionit vlerësues dhe vendimit të AK-së për eliminim, fillimisht duhet të sqarohet se mungesa e fotove nuk është arsyeja e vetme për eliminim të OE ankues.

Pika e parë e eliminimit të OE ankues sipas AK-së është se i njëjti nuk ka ofruar listën e stafit të nënshkruar dhe vulosur ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit, mirëpo ka ofruar një listë të ATK-së për kontributet e paguara.

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues është mungesa e fotove për disa nga pajisjet e ofruara., ku ofrimi i fotove ka qenë kërkesë decitive në dosje të tenderit:

“Dëshmi 5:Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi listën e veglave dhe mjeteve të punës qe posedon e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose kontratën ose marrëveshjen për marrjen me qira të automjeteve.

Veglat dhe mjetet te dëshmohen me foto.”

Pika e tretë e eliminimit të OE ankues ka qenë se OE ankues nuk ka ofruar dëshmi për gjatësinë e kranit. Më konkretisht AK në arsyetim ka potencuar dëshmia për njërin autovinç është për gjatësi 25 metra (më e vogël se ajo e kërkuar në dosje 30 metra), ndërsa për autovinçin tjetër nuk është ofruar dëshmi se sa është gjatësia e autovinçit me korpë.

Eksperti shqyrtues vlerëson se parimisht AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues. Megjithatë vlerësojmë se, pa paragjykuar nëse sqarimet e ofruara nga OE ankues do ishin në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe do të arrinin ose jo të dëshmonin plotësimin e kushteve të dosjes, një veprim i tillë nga AK (kërkesa për sqarime ndaj OE ankues) nuk do të sillte ndryshim në rezultat final dhe vendim të AK-së, pasi para OE ankues është edhe një OE tjetër i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Me qenë se OE ankues nuk ka bashkangjitur dëshmi për të cilat pretendon se do ti plotësonte me sqarime shtesë, vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë ankimorë sipas ankesës nr.863/23 është se AK, për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë prej të cilit ka kërkuar sqarime shtesë, të njëjtin veprim nuk e ndërmarr edhe ndaj OE ankues, do thotë nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues.

OE ankues pretendon se me sqarime shtesë do të dëshmonte se i njëjti i plotëson kërkesat e AK-së.

Eksperti shqyrtues edhe njëher sqaron se parimisht AK ka mund të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues. Megjithatë vlerësojmë se, pa paragjykuar nëse sqarimet e ofruara nga OE ankues do ishin në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe do të arrinin ose jo të dëshmonin plotësimin e

kushteve të dosjes, një veprim i tillë nga AK (kërkesa për sqarime ndaj OE ankues) nuk do të sillte ndryshim në rezultat final dhe vendim të AK-së, pasi para OE ankues është edhe një OE tjetër i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Në cilësi të ekspertit shqyrtues përmes E-Prokurimit kemi kontrolluar nëse OE ankues ka bërë plotësim të ankesës (ashtu siç ka cekur në fund të ankesës), e po ashtu pranë Arkivit të OSHP-së kemi kontrolluar nëse OE ankues ka bërë një veprim të tillë mirëpo nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi shtesë.

Me qenë se OE ankues në ankesë në OSHP nuk ka bashkangjitur dëshmi për të cilat pretendon se do ti plotësonte me sqarime shtesë, vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.

Pretendimi nr.3

Pretendimi tjetër ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një marrveshje me një biznes smajl Jakupaj B.I. me nr 810448557 i cili del të jetë i shuar dhe dokumenti i tillë llogaritet si mashtrim dhe është jo valid që e bënë oferten të papërgjegjshme.

Sipas OE ankues biznesi është I shuar me datë 11.05.2023 dhe OE ka marrëveshjen e nënshkuar me datë 22.06.2023.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se në rastin konkret kemi të bëjmë me një marrveshje në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe një kompanisë "Ismajl Jakupaj B.I." .

Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se për këtë çështje AK ka kërkuar sqarime shtesë, dhe OE i rekomanduar ka ofruar sqarime kemi të bëjmë me të njëjtën kompani e cila e ka ndërruar llojin e biznesit nga:

Biznes Individual (B.I) me emër “**ismajl Jakupaj B.I**” dhe emër trgëtar “**NTP Medruplast**”,
Në:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SHPK), me emër “**Medruplast SH.P.K.**” dhe emër tregëtar “**Medruplast**”, ku prap figuron pronari i njëjtë **Ismajl Jakupaj**.

OE po ashtu ka ofruar “Informata mbi biznesin” nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve, sipas të cilave informata me zbatimin e ligjit për numrin unik identifikues të biznesit me numër unik 810448557 dhe numër biznesi 80098502 me datë 11.05.2023 ky biznes ndërron tipin në “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara” dhe merr numrin e ri të biznesit 812041119 dhe **është vazhdim i biznesit të mëhershëm**.

Provë: Informata mbi biznesin me numrin unik identifikues 812041119

Provë : të dhënat nga faqja zyrtare e Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi nr.4

Pretendimi i fundit sipas ankesës 863/23 është se AK ka bërë shkelje të LPP-së pasi ka vonuar dy muaj kthimin e përgjigjes /vendimit në kërkesë për rishqyrtim.

Sqarojmë se pas kërkesës, lënda për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë në OSHP deri me datë 20.10.2023 kur është lëshuar vendimi i OSHP-së nr.611/23.

AK me 23.10.2023 (pas tri dite) ka ngarkuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Bazuar në faktin se AK-të nuk kanë të drejtë marrin kurrfarë vendimi për aktivitete të prokurimit që janë në procedurë në OSHP, AK ka kthyer përgjigje ndaj OE ankues brenda tri dite pas pranimit të vendimit dhe përfundimit të procedurës në OSHP, andaj vlerësojmë se nuk qëndron pretendimi ankimorë se AK e kanë vonuar dy muaj vendimin në kërkesë për rishqyrtim.

Po ashtu vlerësojmë se vendimi i AK-së nuk është në kundërshtimin e me vendimin e OSHP-së siç pretendon OE ankues, pasi vendimi i OSHP-së nr.611/23 e ka kthyer lëndën në rivlerësim me qëllim të trajtimit të pretendimeve ankimore të kërkesës për rishqyrtim nga ana AK-së (obligim të cilin e ka përmbushur AK).

Rrezultatet e Bizneseve

Nr	Emri	Emri tregtar	Nr.Biznesit	Komuna	Lloji Biznesit	Statusi
1	MEDRUPLAST SH.P.K.	MEDRUPLAST	812041119	Obiliq	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara	Regjistruar
2	Ismajl Jakupaj B.I.	NTP,Medruplast	810448557	Prishtinë	Biznes individual	Shuar

MEDRUPLAST SH.P.K.

Emri i biznesit	MEDRUPLAST SH.P.K.
Emri tregtar	MEDRUPLAST
Lloji i biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Numri unik identifikues	812041119
Numri i biznesit	///
Numri fiskal	///
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	55
Data e regjistrimit	11/05/2023
Komuna	Obiliq
Adresa	Llazarevë, Zona Industriale, pn
Telefoni	+38338604134
E-mail	info@medruplast.com
Kapitali	2,500,000.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Ismajl	Jakupaj	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Ismajl Jakupaj	2,500,000.00€	100.00%

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**SHERBIMET E PASTRIMIT NË OBJEKTET E PK-SË**” me numër të prokurimit: “**214-23-5718-2-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNESEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number
812041119

Shënim me rëndësi / Important Note / Vazan podatak

; Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 80098502, me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810448557 Biznesi individual me emër Ismajl Jakupaj B.I. dhe emër tregtar 'NTP „Medruplast“' themeluar me 12/6/2000 si Biznes Individual me numër unik identifikues 810448557 dhe numër të biznesit 80098502. Me datën: 11-05-2023 ky biznes e ndrron tipin në 'Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar' me emër të biznesit MEDRUPLAST SH.P.K. dhe merr numër të ri të biznesit 812041119 dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

